



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

URDHËR

Nr. 6174, datë 16. 12. 2015

PËR

“PËRCAKTIMIN E DENDËSISË SË PIKAVE TË AKSESIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 7 të nenit 6 dhe pikës 3 të nenit 12, të ligjit nr. 46, datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postare,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit të rrjetit postar për ofrimin e shërbimit universal postar, duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Numri i pikave të aksesit në nivel kombëtar duhet të jetë i tillë, që të sigurojë se:
 - a) Një zyrë postare t'i ofrojë shërbimin universal postar një numri mesatar të popullsisë prej **5100 banorë**;
 - b) Të ketë një zyrë postare mesatarisht në një sipërfaqe prej **53 km²**.
3. Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit duhet të jetë mesatarisht **5 km**.
4. Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit, duhet të jetë mesatarisht **8 km** për të paktën **95% të popullsisë**.
5. Përcaktimi zonë urbane dhe zonë rurale mbështetet në klasifikimin e përdorur në Census 2011.
6. Zyrat postare (të SHU) janë pika aksesit që ofrojnë pranimin e të gjitha llojeve të objekteve postare, pjesë e objektit të Shërbimit Universal. Në çdo zyrë postare duhet të ketë të paktën **1 (një)** kuti postare që shërben për pranimin e objekteve të thjeshta postare sipas përcaktimeve në rregulloret e UPU-së.

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail: info@inovacioni.gov.al

7. Ofruesi i shërbimit universal postar duhet të informojnë AKEP-in për çdo ndryshim të vendndodhjes së zyrës/zyrave postare ose të numrit të pikave të aksesit dhe duhet të japin arsyet e këtyre ndryshimeve.
8. Përcaktimi i dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar do të rishikohet çdo pesë vjet, por jo më vonë se 1 vit para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të lëshuar nga AKEP-i për Ofruesin/Ofruesit e Shërbimit Universal Postar.
9. Ngarkohet Ofruesi i Shërbimit Universal Postar për zbatimin e këtij urdhri dhe AKEP-i për ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, dhe efektet e zbatimit të tij nga data 1 janar 2016.

MINISTËR

Milena HARITO



Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave

Tel: +355 4 2277355

E-mail. info@inovacioni.gov.al